

Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel akademik pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës në Departamentin e Arkitekturës, si dhe në Departamentin e Urbanistikës.

A. Departamenti i Arkitekturës shpall 1 (një) vend të lire për personel akademik me kohë të plotë në kategorinë “Asistent-lektor”, në lëndët “Vizatim i lirë dhe Histori Arti” si dhe Bachelor në “Arkitekturë Interieri e Dizajn”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë në Arkitekturë;
2. Të kenë notë mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të të dy cikleve apo të ciklit të integruar, **jo më pak se 80/100** (Statuti i UPT-së neni 42, pika b);
3. Të kenë të paktën 3 vite eksperiencë profesionale dhe akademike;
4. Të zotërojnë me dëshmi të paktën një nga gjuhët: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht;

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- 1) Letër motivimi ku të përfshijë:
 - a. Pozicionin e kërkuar
 - b. Arsyet e kandidimit
 - c. Çfarë i ofron kandidati institucionit/departamentit/grup-lëndëve
 - ç. Përmbledhje mbi qasjen teorike/metodologjike të kandidatit për lëndët ku do të angazhohet (500 fjalë);
- 2) Jetëshkrimin (CV) e plotë akademike dhe profesionale;
- 3) Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- 4) Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
- 5) Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
- 6) Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
- 7) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 8) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
- 9) Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.
- 10) Letër reference nga 2 persona me gradë ose titull akademik (referenca të paraqitet me zarf të mbyllur të firmosur nga referenti);
- 11) *Portfolio* punësh të lidhura me disiplinat e vendit vakant;
- 12) Letër reference nga punëdhënësi i fundit.

Nëse ka kandidati mund të paraqesë edhe:

1. Kopje të noterizuar të gradës shkencore, si dhe një përmbledhje të tezës së kryer. Gradat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me dokumentin e njohjes dhe njehsimit nga MAS.
2. Deri në dy publikime të plota të përzgjedhura (artikull, ese, punime shkencore etj).
3. Dokumente të tjera plotësuese të cilat lidhen me aplikimin.

B. Departamenti i Urbanistikës shpall 1 (një) vend të lirë për personel akademik në kategorinë “Asistent-lektor” për lenden “Baza e projektimit urban dhe elemente të peizazhit”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë “Master i Shkencave” të ciklit të dytë në Arkitekturë dhe/ose Urbanistikë;
2. Të kenë notë mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të dy cikleve apo të ciklit të integruar, jo më pak se 80/100;
3. Preferohet mesatarja e lëndëve të fushës së urbanistikës mbi 9;
4. Të kenë të paktën 5 vite eksperiencë profesionale dhe/ose akademike;
5. Preferohet të kenë kryer kurse ose kualifikime brenda dhe jashtë vendit në fushat përkatëse;
6. Të zotërojnë me dëshmi të paktën një nga gjuhët: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, spanjisht.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

4. Letër motivimi ku të përfshijë:
 - a. Pozicionin e kërkuar
 - b. Arsyet e kandidimit
 - c. Çfarë i ofron kandidati institucionit/departamentit/grup-lëndëve
 - d. ç. Përmbledhje mbi qasjen teorike/metodologjike të kandidatit për lëndët ku do të angazhohet (500 fjalë);
5. Jetëshkrimin (CV) e plotë akademike dhe profesionale;
6. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
7. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);

8. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
9. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
10. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
12. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Nëse ka kandidati mund të paraqesë edhe:

13. *Portfolio* punësh të lidhura me disiplinat e vendit vakant;
14. Kopje të noterizuar të gradës shkencore, si dhe një përmbledhje të tezës së kryer. Gradat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me dokumentin e njohjes dhe njehsimit nga MAS.
15. Deri në dy publikime të plota të përzgjedhura (artikull, ese, punime shkencore etj).
16. Dokumente të tjera plotësuese të cilat lidhen me aplikimin.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **21.10.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.